

Raporti nga kampi veror për persona me lëndime të palcës kurrizore “Ulqini 2007” Grupi i – II-

Nga 27 gusht – 6 shtator 2007



Mbështetur dhe financuar nga Onlus R. Bazzoni
Organizuar dhe implementuar nga HandKOS i

Personeli:

Përgjegjës i kampit: Afrim Maliqi
Përgjegjësit për seanca: Haki Oruçi
Aktivitet Sportive: Luan Çabra
Plazhin: Taf Fazliu
Teknike mjekësore: Kimete Shabani
Vozitës: Hajriz Muli
Pjesëmarrës: 54 persona
24 paraplegjik
2 tetraplegjik
3 paraparesë
16 përcjellës personal
5 personeli përgjegjës



Ekipi televiziv: - 3 veta
Psikologja – 1 person

Gjinia: Meshkuj – 21
Femra – 9

Udhëtimi: Udhëtimi ishte dy ditë. Një autobus nga kompania turistike "Lindi Tours", me 46 pjesëmarrës.
Një automjet nga HandiKOS`i, me 5 pjesëmarrës dhe pajisjet Sportive, si dhe një automjet me të cilin kishin ardhur ekipi televiziv.

Udhëtimi:
Nisja nga Prishtina është bërë me 26 gusht në mbrëmje nga parkingu i HandiKOS`it, kurse kthimi nga Ulqini në Prishtinë është bërë më 7 shtator në mëngjes.

Hyrje:
Edhe këtë vit, plani dhe orari i gjitha aktiviteteve ishte përgatitur para shkuarjes në kamp e po ashtu edhe detyrat dhe përgjegjësitë ishin të ndara për çdo aktivitet të cilat u caktuan nga mbledhja e mbajtur në Prishtinë. Pjesëmarrësit janë përzgjedhur nga personat "përkrahës" - peer support të cilët kanë punuar gjatë vitit me këta njerëz por duke i plotësuar kriteret e pjesëmarrjes. Po ashtu sikurse edhe në grupin e fëmijëve, edhe në këtë grup ka qenë prezentë ekipi i Radio Televizionit të Kosovës të cilët i kanë përcjellë të gjitha aktivitetet dhe kanë zhvilluar intervista me pjesëmarrës.

Sikur e përmendëm edhe në grupin e fëmijëve, po ashtu edhe këtë vit organizimi i kampit për persona me lëndime spinale (grupi i II) është bërë në vendin e njëjtë, Hotel Bellevue, Plazhi i madh, Ulqin (Mali i zi).

Dita e parë, prezantimi i aktiviteteve dhe pjesëmarrësve

Ditën e parë në mbrëmje, nga përgjegjësi i kampit dha një histori të shkurtër për punën HandiKOS' it-it dhe për kampet e organizuara deri më tani të cilat janë mbështetura financiarisht nga Onlus R. Bazzoni. Pastaj u bë edhe prezantimi i orarit të aktiviteteve të kampit , i cili ka qenë i vendosur në dy hyrjet e korridoreve të Hotelit dhe më pas u bë prezantimi i të gjithë pjesëmarrësve.

Gjymnastika e mëngjesit – më qëllim të zhvillimit të kondicionit, gjendjes fizike si dhe parandalimit të kontrakturave apo deformiteteve të ndryshme, çdo mëngjes është mbajtur gjymnastika e mëngjesit e cila është udhëhequr nga vet përgjegjësi i kampit. Në kuadër të gjymnastikës janë mbajtur edhe ushtrime tjera si: ngritja e peshoreve (shisheve), baraspesha me top dhe ushtrime tjera.



Përdorimi i karrocës

Po ashtu, më qëllim të përdorimit sa më të mirë të karrocës, çdo dit pas gjymnastikës janë zhvilluar aktivitetet me karroca. Në këtë aktivitet ka pasur persona të cilët kanë qenë të lënduar më vonë e të cilët me t'vërtetë kanë arritur që të krijojnë një pavarësi më të madhe për aktivitetet e tyre të përditshme e sidomos kur kemi parasysh kushtet e tyre të vështira dhe pengesat fizike



që ata ballafaqohen në shtëpitë e tyre por edhe në rreth. Ushtrimet që janë mbajtur për këtë a

ktivitet kanë qenë: baraspesha e karrocës, kalimi i pengesave, transferimet nga karroca dhe anasjelltas dhe shumë tjera.

Sikur edhe çdo vit, me disa persona është dashur të punohet më tepër të cilët kanë më të varur dhe të cilët kanë pasur lëndim më të vonshëm.

Plazhi – koha për plazh ka qenë shume e mire dhe e nxehtë përveç në dy ditët e fundit kur edhe filloi ndryshimi dhe filloi nga pak edhe të binte edhe shi.

Dalja në plazh ka qenë në mënyrë të organizuar dhe është mbajtur çdo dit pas mbarimit të gjimnastikës, ushtrimeve me karroca dhe kalimit të pengesave.

Për dallim nga vitet e



kaluara, këtë vit ka qenë për befasi të mirë kur qysh ditën e parë të gjithë kanë hyrë në ujë, viteve të kaluara disa gjithmonë hezitnin të hynin jo për arsye që nuk dinin të notonin por kishin komplekset dhe paragjykimet që nuk mundën. Suksesi ka qenë në organizimin e mire dhe përgjegjësitet që kanë të ngarkuar me këtë aktivitet por edhe nga personat të cilin kishin përvojë më të madhe duke i përkrahur dhe shpjeguar rëndësinë e ujit.

Disa veta, pas dy ditëve kanë arritur të heqin gomat ndihmëse që mbanin rreth tyre dhe të mbanin baraspeshën në ujë.

Aktivitetet sportive – pas plazhit, çdo pasdite janë organizuar aktivitete sportive si: basketboll, loja ndërmjet dy zjarreve dhe aktivitete tjera me top, Kurse në mbrëmje janë mbajtur aktivitetet sportiv: ping-pongu dhe shahu, gjithashtu një ping-pong dhe shah janë organizuar edhe turnirë individual. Te gjithë ishin aktiv dhe pjesëmarrës në te gjitha aktivitetet që u organizuan Brenda këtyre ditëve.



Seancat - këto seanca kanë pasur për qëllim shkëmbimin e përvojave mes pjesëmarrësve, përmes diskutimeve nga ata të cilët kanë pasur përvojë më të mirë. Është diskutuar për problemet të cilat i preokupojnë personat me lëndime spinale si: inkontineca, zbrazja e zorrëve, parandalimi i varrës dekubitare, jeta

seksuale dhe çështje tjera të cilat ballafaqohen personat me lëndime spinale në jetën e përditshme.

Është vërejtur se të këto seanca kanë qenë shumë të mirëpritura e sidomos për ata të cilët kanë pasur lëndim më të vonshëm e për të cilët ka qenë hera e parë që diskutohet për këto çështje. Seancat kanë qenë të organizuara në tri gupe: meshkujt, femrat dhe përcjellësit dhe janë mbajtur dy herë, por është diskutuar edhe në mënyrë individuale të cilët janë përzgjedhur nga përgjegjësi i kampit dhe janë mbajtur nga "përkrahësit" (peer support).

Ishin disa pjesëmarrës të cilët kishin pasur lëndime të vonshme e të cilët kalonin nëpër udhëkryqet e para dhe ndaj tyre kërkohej kujdes dhe përkrahje edhe më të madhe.

Dalja në qytet- ne mesin e pjesëmarrësve, ka pasur njerëz të cilët shumicën e kohës e kalojnë mbyllur në shtëpi për arsye të ndryshme: paragjykimet dhe kushtet në të cilat jetojnë dhe për këtë arsye gjatë këtij kampi kemi organizuar edhe daljen në qytet.

Një ditë është organizuar dalja në qytet me të gjithë pjesëmarrësit, ku të gjithë kemi dalë me karroca, ndërsa në mbrëmje të gjithë ata që kanë dëshiruar ta vizitojnë qytetin në plazhin e vogël janë organizuar në grupe dhe kjo është bërë e mundur me veturën e HandiKOS-it.

Gjatë kohës së kampit, një pjesëmarrëse Adelina Berisha kishte ditëlindjen dhe asaj i organizuam një festë simbolike e cila ishte tejet e gëzuar dhe ishte hera e parë e saj që merrte pjesë në kamp.

Kujdesi mjekësor – gjatë gjithë kohës së qëndrimit në kamp ishte permanent. Ka pasur disa raste disa raste me Infeksione urinare , plogështi nga të nxitit , tensione gjaku të larta si dhe si dhe dy raste me varre dekubitare, por meqenëse motra medicinave ishte me mjaft me përvojë që kishte fituar nga vitet e kaluara si dhe pajisjet mjekësore që kishim marrë me vete i tejkaluam të gjitha me mjaft sukses.



Mbrëmja e fundit (party)-sikurse çdo vit edhe kësaj radhe organizuam një party me të gjithë pjesëmarrësit dhe edhe kësaj radhe na u bashkëngjitën edhe pjesëmarrësit nga grupi i personave me aftësi të kufizuar të ndryshme (grupi i III).

Po ashtu në këtë mbrëmje nga një pjesëmarrës i cili kishte prirje për aktrim, organizuam një shfaqje teatrale. Nga të gjithë vërehej kënaqësia që kishin kaluar këto ditë dhe të gjithë vallëzonin prej gëzimit dhe për shumicën ishte hera e parë që vallëzonin me karroca.



Përgjegjësi i kampit
Afrim Maliqi